



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në: Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d)

Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MA-NR. 16//2006

përcaktimin e taksave për shërbime të kontrollit fitosanitar në pikat kufitare

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen rregullat për caktimin e taksave për shërbime të kontrollit fitosanitar në pikat kufitare dhe përcaktohet lartësia e kompensimit të taksave për shërbimet fitosanitare të cilat Inspekcioni Fitosanitar Kufitar i Agjencionit të Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës i kryen në vendkalimet kufitare të Kosovës, të cilat importohen në Kosovë e veçanërisht për kontrollimin e farërave, frutave të perimeve, kërpudhave dhe zhardhokëve, frutave të thata, aromave dhe aditivëve të ushqimit me origjinë bimore, produkteve të duhanit, fidanëve dhe bimëve dekorative, produkteve me origjinë bimore të papërpunuara ose i janë nënshtruar përgatitjeve të thjeshta për ekstraktim mekanik si: mielli, lëngjet e frutave dhe perimeve, vaji nga perimet, ushqimi industrial dhe foragjeret e papërpunuara, plehrat organike dhe inorganike, pesticidet e materie të tjera në lëmin e fitosanitarëve.

Neni 2

Sipas llojit të produkteve që importohen në Kosovë, përcaktohet edhe lartësia e taksave në €
Taksat për shërbimet e inspektimit fitosanitar në kufi janë me sa vijon: (SHFK).

Farërat (*)	
Fara për mbjellje, ushqim, ushqimi i kafshëve dhe /ose fara për përpunim industrial (p.sh. fara e drithërave, farat bishtajore, etj.). Duke përfshirë kokrrën e drithërave ose produkteve të tyre. Ngarkesat deri në 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës deri €20	€2 / t
Fara e perimeve	
Nga 0.5 kg deri 5.0 kg	€15
Nga 5.0 kg deri 50 kg	€20
Nga 50 kg deri 500 kg	€30
Mbi 500 kg Për çdo 100 kg ,në vazhdim të tarifës prej €30 -	€5 / kg
Frutat (*)	
Frutat e freskëta të citrusëve (limoni, portokalli, mandarina dhe llojet tjera të pemëve Molla, Dardha, Kajsia, Pjeshka, Qershia etj. Thelboret arra, lajthia etj. Ngarkesat deri në 1.0 ton	€20 t
Ngarkesat mbi 1 ton – Në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2/t
Perimet (*)	
Perimet e freskëta ose të ngrira (speci, spinaqi, domatet, lakra, trangulli, karota, shalqiri, kungulli, patate etj. Ngarkesat deri 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Perimet e bluara (p.sh. biber, mëlmesa e ndryshme) Ngarkesat deri në 1.0 ton	€20 €2/t
Kafe, Kakao (produktet e tyre)	€30
Ngarkesat mbi 1 ton — në vazhdim të tarifës prej €30 -	€4 / t
Kërpudhat dhe zhardhokët (*)	
Kërpudhat dhe zhardhokët, të freskëta ose të ngrira, dhe të përgatitura ose të konservuara në uthull ose acid acetik. Ngarkesat deri 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton– në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Frutat e thata (*)	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton– në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Pure të pemëve	€20
Peme të shtrydhura ose bluara Ngarkesa mbi 1 ton-ne vazhdim të tarifës prej €20	€2/t
Të thata dhe /ose gjethe të bluara dhe /ose tjera të bimëve (*) (çaji, gjethe të bimëve që përdoren si çaj etj.). Ngarkesat deri 1.0 ton	€30
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €30	€3 / t

Bërthamoret dhe Batha	
Bërthamoret dhe bathët e pa përpunuara, duke përfshirë në mes tjerash me lëvore dhe lëkurë që përmban çfarëdo proporcioni.	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Aromat (*) dhe aditivët e ushqimit me origjinë bimore	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€30
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €30 -	€3 / t
Prodhimet e Duhanit (*) (i. e. Cigaret, produktet e duhanit, etj.).	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€30
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €30 -	€5 / t
Zhardhoku i patates (*)	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€30
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €30 -	€2 / t
Bulborët (*) (qepët, hudhrrat lulet e bulborëve, etj.).	
Ngarkesat deri 1.0 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – Në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Fidanët (*)	
Fidanët e pemëve	
Ngarkesat deri 100 copë	€20
Ngarkesat mbi 100 copë – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€0.02 / copë
Fidanët (*)	
Fidanët e perimeve	
Ngarkesat deri 100 copë	€20
Ngarkesat mbi 100 copë –në vazhdim të tarifës prej €20 -	€ 1 /në çdo 100 copë shtesë
Fidanët (*)	
Fidanët e hardhisë së rrushit	€20
Ngarkesa deri 100 copë në vazhdim të tarifës 20	€0.01 për copë
Bimët Dekorative (*)	
Ngarkesat deri në 100 copë	€30
Bimët dekorative (lulet e prera, drunjte e kërsëndellave etj .) deri në 70 cm - në vazhdim të tarifës prej €30-	€0.01 / copë
Bimët dekorative (lulet e prera , drunjte e kërsëndellave etj) mbi 70 cm - në vazhdim të tarifës prej €30-	€0.02 / copë
Bimët në vazo	
Ngarkesat deri në 100 copë	€40
Bimët në vazo deri në 70 cm -në vazhdim të tarifës prej €40 -	€0.02 / copë
Bimët në vazo mbi 70 cm - në vazhdim të tarifës prej €40 -	€0.04 / copë
Druri (*)	
Drurët me lëvore	2€m ³

Drurët pa lëvore	2 €/m ³
Lëvoret e ndara	1 €/m ³
Paletat nga drunjtë, paletat kuti materialet drusore për paketim etj .	2 €/m ³
Dru zjarri, byk sharre, etj .	1,5 €/m ³
Produktet me origjinë bimore, të pa përpunuara ose i janë nënshtruar përgatitjeve të thjeshta dhe / ose ekstraktim mekanik sikurse:	
a) Mielli dhe prodhimet e Miellit	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton –Në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
b) Lëngjet e frutave dhe perimeve	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
c) Vaji nga bimët industriale dhe perimet	
Ngarkesat deri në 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton –në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Ushqimi industrial dhe foragjeret e pa përpunuara (*) (fara për vaj industrial, panxhari i sheqerit, kallam sheqeri pambuku i pa përpunuar dhe fijet e perimeve të industrisë foragjeret e bluara të perimeve dhe miell misri i rëndomtë, foragjeret e përziera etj .)	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20-	€2 / t
Panxhar sheqeri dhe produktet e tij (sheqeri për konsum)	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Plehrat, humusi, përzierje plehrash organike dhe inorganike dhe materialet e dedikuara për kultivim të bimëve (*)	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – Në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
Dheu (*)	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton – në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2 / t
(*) Kërkohet Certifikata Fitosanitare.	
Plehrat inorganike	
Ngarkesat deri 1 ton	€20
Ngarkesat mbi 1 ton –Në vazhdim të tarifës prej €20 -	€2/ t
Pesticidet	
Ngarkesat deri 100 / lt	€30
Nga 100 kg deri 1 ton	€60
Mbi 1 ton vazhdim të tarifës prej €60 -	€ 10/ çdo 1 ton shtesë

Neni 3

Taksat për shërbimet fitosanitare, të kryera në vendkalimet kufitare të Kosovës sipas lartësisë dhe llojit të produkteve të cilat i nënshtrohen kontrollit fitosanitar kufitar nga neni 2 i këtij udhëzimi administrativ, duhet të paguhen me të kontrolluar të ngarkesës.

Neni 4

Për leje të importit të produkteve nga neni 2 i këtij udhëzimi administrativ, importuesi është i obliguar që të paguaj taksën prej 40€.

Leja e importit vlen tre (3) muaj nga dita e lëshimit.

Neni 5

Të hyrat e grumbulluara nga kontrolli fitosanitar derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 6

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ pushon së aplikuari Udhëzimi Administrativ Nr. 2001/03 i dt. 29 qershor 2001 për përcaktimin e taksave për shërbime të kontrollit fitosanitar në pikat kufitare të kontrollit.

Prishtinë, 25.07. 2006

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Zëvendësministri,
Tomë Hajdaraj
